



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Ae.nr.8/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Rrustem Thaqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve “[V...]”, me seli në Zvicër, të cilin e përfaqëson “[I...]“ L.L.C. nga Prishtina, - [B.N], kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “[E...]”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit, [F.SH] nga Prishtina, për shkak të regresit, në shumën e përgjithshme prej 2,221.24€, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, III.EK.nr.682/2019, të datës 08.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.05.2021 mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHEN** si të pabazuara ankesat e paditësit Kompania e Sigurimeve “[V...]”, me seli në Zvicër dhe të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig”, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, III.EK.nr.682/2019, të datës 08.10.2020, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Kompania e Sigurimeve “[V...]”, me seli në Zvicër, ku në piken I të dispozitivit është detyruar e paditura Kompania e Sigurimeve “[E...]”, me seli në Prishtinë që paditësit Kompanisë së Sigurimeve “[V...]”, me seli në Zvicër t’ia paguaj në emër të regresit nga baza e sigurimit auto kasko, shumën e përgjithshme prej 2,221.24€, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data 15.11.2019 e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim. Ndërsa në piken II të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 937,30€, në afatin kohor prej 7 ditëve nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura Kompania e Sigurimeve “[E...]”, me seli në Prishtinë, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoje ankesën e të paditurës si të bazuar, dhe aktgjykimin, III.EK.nr.682/2019, të datës 08.10.2020 ta ndryshoje ashtu që të gjykoje shumën dukshëm më të lira.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë edhe pala paditëse Kompania e Sigurimeve “[V...]”, me seli në Zvicër për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovoje ankesën e paditësit dhe të ndryshohet aktgjykimi III.EK.nr.682/2019, të datës 08.10.2020 në pikën I, ashtu që e paditura të paguaj kamatëvonesën prej 12% në vit duke filluar nga data 16.08.2018 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimin, nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë dhe në pikën III, ashtu që e paditura detyrohet të paguaj shpenzimet e kontestit në shumën prej 1,175.00€.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK, gjeti se:

**ankesat janë të pabazuara.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Kompania e Sigurimeve “[V...]”, me seli në Zvicër, me datën 15.11.2019 ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “[E...]”, me seli në Prishtinë, për shkak të regresit nga baza e sigurimit auto kasko, të pësuar nga aksidenti i komunikacionit të datës 18.04.2018 për çka edhe ka kërkuar nga gjykata që t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2,182.68€, me kamatë ligjore prej 12% duke filluar nga data 16.08.2018 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Paditësjë pas nxjerrës së ekspertizës së makinerisë të punuar nga z. Sjedi Berisha të datës 23.09.2020 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në shumën e përgjithshme prej 2,391.80 CHF.

Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara ka konstatuar se meqenëse së e paditura, nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë dhe ka pranuar përgjegjësinë lidhur me shkaktimin e demit, gjykata nuk është lëshuar në shqyrtimin e provave të cilat i referohen rrethanave, vendit dhe pjesëmarrësve në aksident si dhe përgjegjësinë për kompensimin e demit, por kontestuese sipas pretendimeve të autorizuarit të paditurës kontestuese në mes palëve në procedurë ka qenë lartësia e demit. Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së palës paditëse, është bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertizës së ekspertit të makinerisë z. [S.B] të datës 23.09.2020 për të vërtetuar lartësinë e demit, ku ka vërtetuar faktin se automjeti “Audi A4” me targa të regjistrimit [...] ka pësuar dëmtime të mesme, riparimi i të njëjtit teknikisht është i mundur dhe ekonomikisht i arsyeshëm, ku ka konstatuar së ka pësuar dëm material në automjet në shumën prej 2,391.80CHF, që është e barasvlershme me 2,221.24€. Prandaj, gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë e

paditësit duke u bazuar në dispozitat e nenin 136 paragrafi 1, 960 par.1, të LMD-së, si dhe në nenin 143 paragrafi 1 të LPK-së.

Bazuar në dispozitat ligjore, gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke vlerësuar se me pagimin e kompensimit të dëmit nga paditësja, të gjitha të drejtat e të siguruarit kanë kaluar të paditësja dhe e paditura ka pasur obligim t'ia rimbursojë paditëses shumën e paguar në emër të kompensimit të dëmit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 136 paragrafi 1 të LMD-së me të cilin është përcaktuar se “*kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet së dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”, ndërsa në dispozitën e nenit 960 par.1 të LMD-së, me të cilin është përcaktuar se “*me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin, në bazë të vetë ligjit, deri në shumën e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguruarit ndaj personit i cili mbi cilën bazë qoftë është përgjegjës për dëmi*”.

Ndërsa në nenin 281 të LMD-së është përcaktua së “*kur detyrim e përmbush personi, i cili ka ndonjë interes juridike në këtë çështje, atëherë i kalon atij, në bazë të vete ligjit, në çastin e përmbushjes, kërkesat e kreditorit me të gjitha kërkesat aksesore*”, ndërsa në nenin 3 të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia është përcaktuar së “*siguruesi është përgjegjës për kompensimin e dëmeve të shkaktuara personave të trete, nga përdorimi i automjetit të siguruar mbi bazën e auto përgjegjësive*”. E drejta e paditësit për subrogimin e kërkesës mbështetet edhe në ligjin e veçante, përkatësisht nenet 25 dhe 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia.

Ne rastin konkret rrjedh së paditësi si sigurues i automjetit të aksidentuar mbi bazën e sigurimit auto kasko ka qene i detyruar ta kompensoje dëmin e shkaktuar mbi automjetin e siguruar, të cilën edhe e ka bërë dhe gëzon të drejtën që të regresojë shumën e paguar nga i padituri i sigurues i automjetit “BMW” me targa të regjistrimit [...], mbi bazën e sigurimit nga auto përgjegjësia për demet e shkaktuara personave të trete.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet, lidhur me lartësinë e normës së kamatës, por gjeti se të njëjtat janë ta pabazuara, ngase neni 382 par.2, i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, përcakton lartësinë e kamatës prej 8%, andaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të palëve , lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë ta pabazuara, sepse gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar gjendjen faktike, Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, është plotësisht i pabazuar pretendimi ankimor për vërtetim jo të plotë të gjendjes faktikë sepse nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë ka administruar të gjitha provat ne dispozicion dhe ka shfrytëzuar të gjitha mjetet provuese për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,**  
**Ae.nr.8/2021, dt. 19.05.2021**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**

**Mahir Tutuli, d/v.**

